



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PUKE

Nr. \_\_\_\_ prot

Datë 06.02.2024

**PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - MALL**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** Blerje karburant gazoil deri ne 10 ppm (Nafte D1,Eurodiesel),Bashkia Puke.Lloji i procedures se prokurimit te jete, “E hapur e Thjeshtuar”Mallra

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**  
Karburante 09100000-0:

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 4,833,333 (Kater milion e teteqinde e tridhjetete e tremije e treqinde e tridhjetete e tre ) leke pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Puke** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;*

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

2.1.1. Sipas Shtojcës 7, pika 1 ”Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”.

**Argumentim:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar

## **2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:**

a) *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë “Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të lëshuara nga administrata tatimore për vitet 2021,2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë sa 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet”.* Në plotesimin e kësaj pike operatori ekonomik duhet të paraqese: Vertetim nga Dega e Tatim-Taksave për xhiron e realizuar gjatë viteve të sipërpërmendura.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Kërkohet për 2 vitet e fundit duke marrë në konsideratë vlerën e objektit dhe për të qenë sa me konkurruese për të gjithë op.ekonomik te vegjel apo te medhenj.Po ashtu theksojme se është formuluar (sa 40% e vlerës së kontratës sipas rekomandimit të lënë nga KLSH)

b. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021,2022 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të **kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar**, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, **kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar**

Kërkohet për 2 vitet e fundit duke marrë në konsideratë vlerën e objektit dhe për të qenë sa me konkurruese për të gjithë op.ekonomik te vegjel apo te medhenj.

c.Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2023 sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin.

*Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.*

**Shënim:** Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë sa 20 % të vlerës së fondit të limit që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.
- b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 40 pika 4 si dhe neni 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë sa 20% të vlerës së fondit të limit që prokurohet që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë apo mundësinë e OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe se nuk sjell kufizim të konkurrencës. Kjo vlerë është brenda limiteve të përcaktuara në LPP,

si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë*

**2.3.2** Subjekti ofertues duhet të ketë minimalisht 1(një) stacion të tregtimit me pakicë të karburantit brenda territorit të Bashkisë Puke, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas kodit civil dokumentin e pronesisë (shoqeruar me hartën treguese hipotekore) ose kontratën noteriale të qerases me afat të pakten 1 vjeçar (me të njëjtin dokumentacion bashkangjitur), të stacionit të tregtimit me pakicë të karburanteve, stacioni i cili duhet të jetë brenda territorit të Bashkisë Puke.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Në zbatim të dispozitave të sipërcituara gjykojmë se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapacitetëve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, kapacitetet organizative, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

**2.3.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Raport analizimi për tregun e brendshëm, për cilësinë e karburantit, lëshuar nga Inspektoriat Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e hapjes së ofertave.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”; nenit 40 pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe ligjit Nr.10433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që mund të dorëzojnë dëshmi për rezultate të testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Fletë analize të karburantit është një dokument i rëndësishëm, pasi dokumenton cilësinë e karburantit të tregtuar nga OE. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të karburanteve të tregtuara. Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-sepër ofrimin e karburantit cilësor.

**2.3.4** Subjekti ofertues duhet të paraqesë **dhe deklaratat si më poshtë:**

a. Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin pranë stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë në shërbim 24 orë me kartë elektronike të personalizuar me targën e çdo automjeti të autoritetit kontraktor ose tollona sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

b. Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike.

**Argumentim:** Në bazë të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, për të

garantuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe dhënia e sigurisë AK-së që kontrata do të realizohet sipas kërkesave.

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje tregtimi me pakicë të lëndëve djegëse Karburante *ose* Licencë për tregëtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm naftës për automjete, vajrave lubrifikant.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, *Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë*” nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

**2.3.6** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Vërtetim të lëshuar nga ISHTI , që të provojë se ka importuar dhe /ose ka tregëtuar karburante sipas standarteve të legjisllacionit Shqiptar dhe ofertuesi nuk ka pasur penalitete për shkelje të cilësisë të karburantit, për vitin 2023

**Argumentimi:** Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues nuk është e penalizuar nga autoritetet përkatëse për abuzim me cilësinë e karburanteve, duke ofruar një garanci se nuk do të ketë të tilla abuzime as me sasinë e karburantit të prokuruar. Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-seNr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

**2.3.7**Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentacion vërtetues për protokoll-matjet,verifikimi metrologjik për saktësinë e sasive të hedhjes së karburantit për instrumentat matës (pistoletat e shpërndarjes së karburantit)

**Argumentimi:** Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues ofron sasinë e plote të furnizimit të mjeteve, duke ofruar një garanci se nuk do të ketë të tilla abuzime as me sasinë e karburantit të prokuruar. Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-seNr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

## ***II. Argumentimi i specifikimeve teknike***

**Naftë, Euro Diesel D1 (Gazoil 10 ppm), me specifikime teknike si më poshtë (referuar standardit SSH EN 590:2013+A1:2017)**

| Substanca  | Njësia matëse         | Limitet (normat) |            | Metoda e provës                              |
|--|-----------------------|------------------|------------|--|
|  |                       | Minimum          | Maksimumi  |  |
| Numri i Cetanit  |                       | 51               | -          | EN ISO 5165<br>EN 15195<br>EN 16144          |
| Indeksi Cetanit  |                       | 46,0             | -          | EN ISO 4264                                  |
| Densiteti në 15 gradë celsius  | Kg/m <sup>3</sup>     | 820,0            | 845,0      | EN ISO 3675<br>EN ISO 12185                  |
| Hidrokarbure Polycyclic aromatike  | % (m/m)               | -                | 8,0        | EN 12916                                     |
| Përmbajtje squfuri   | mg/kg                 | -                | 10,0       | EN ISO 20846<br>EN ISO 20884<br>EN ISO 13032 |
| Përmbajtje Mangani Deri 31-12-2013 Nga 01.01.2014 në vazhdim             | mg/l                  | -<br>-           | 6,0<br>2,0 | Pr EN 16576                                  |
| Pika e ndezjes   | Gradë celsius         | Mbi 55           | -          | EN ISO 2719                                  |
| Karboni i mbetur (në 10% mbetje distilati)                               | % (m/m)               | -                | 0,30       | EN ISO 10370                                 |
| Përmbajtja e hirit   | % (m/m)               | -                | 0,010      | EN ISO 6245                                  |
| Përmbajtja e ujit  | mg/kg                 | -                | 200        | EN ISO 12937                                 |
| Kontaminimi total  | mg/kg                 | -                | 24         | EN 12662                                     |
| Gërryerja e shiritit bakrit (3 orë në 50 gradë celsius)                  | Grada                 | Grupi 1          |            | EN ISO 2160                                  |
| Përmbajtja e Acidit të ngopur metil ester FAME                           | % (V/V)               | -                | 7,0        | EN 14078                                     |
| Qëndrueshmëria e oksidimit   | g/m <sup>3</sup><br>h | -<br>20          | 25<br>-    | EN ISO 12205<br>EN 15751                     |
| Lubrifikimi, diametri i veshjes së mprehte (ësd 1,4) në 60 gradë Celsius | µm (micrometer)       | -                | 460        | EN ISO 12156-1                               |
| Viskoziteti në 40 gradë Celsius  | Mm <sup>2</sup> /s    | 2,000            | 4,500      | EN ISO 3104                                  |

|  |               |    |              |             |
|--|---------------|----|--------------|-------------|
| Distilimi  |               |    |              | EN ISO 3405 |
| % (V/V) rafinimi në 250 gradë celsius  | % (V/V)       |    | Më pak se 65 | EN ISO 3924 |
| % (V/V) rafinimi në 300 gradë Celsius  | % (V/V)       | 85 |              |             |
| 95 % (V/V)rafinimi në  | Gradë celsius |    | 360          |             |
| <p>a. Për qëllimet e këtij Standardi Evropian, hidrokarbonet policiklikë aromatikë janë caktuar si përmbajtja totale e hidrokarboneve aromatike më pak se përmbajtja e hidrokarboneve mono-aromatike, të dyja të përcaktuara në EN 12916.</p> <p>b. Investigimi i mëtejshëm për kontaminimin total në metodën e provës për përmirësimin e saktësisë, veçanërisht për prezencën e FAME, nën mbikëqyrjen e CEN.</p> <p>c. FAME i përkojnë kërkesat e EN 14214, shih (3).</p> <p>d. Kur karburantet e naftës përmbajnë më shumë se 2 % (V/V) FAME , qëndrueshmëria e oksidimit e përcaktuar në EN 15751 është kërkesa për të.</p> <p>e. Për llogaritjen e indeksit të Cetanit 10%, 50 % dhe 90% (V/V)nevojiten gjithashtu pikat e RECOVERY.</p> <p>f. Limitet e distilimit në 250 gradë Celsius dhe 350 gradë Celsius janë përfshirë në tarifën e karburantit naftë të Doganave të përbashkëta të BE.</p> <p>g. EN ISO 3924 jep instruksione për konvertimin në ISO 3405-të dhëna ekuivalente. Shih gjithashtu 5.7.5.</p> |               |    |              |             |

**Argumentimi:** Lëndët djegëse lëngët për automjete duhet të jenë sipas standardit SSH EN 590:2013+A1:2017, Metodat e provës ICS 75.160.20 Miratuar në Komitetin Teknik 19 Ratifikuar me dt. 22.11.2013.Ky standard është i njejtë me Standardin Evropian EN 590:2013 dhe ka statusin e Standardit Shqiptar. Ky Standard Evropian u miratua nga CEN më 26 Korrik. Anëtarët e CEN-it janë të detyruar të zbatojnë Rregulloret e Brëndshme të CEN/CENELEC, të cilat përcaktojnë kushtet sipas të cilave këtij Standardi Evropian duhet t'i jepet statusi i një standardi kombëtar pa i bërë asnjë ndryshim. Për sa u përket devijimeve dhe rekomandimeve bibliografike të deritanishme për standarde kombëtare të tilla, mund të merren për zbatim vetëm nga Sekretariati Qendror ose nga njeri prej anëtarëve të CEN-it. Ky Standard Evropian ekziston në tre versione zyrtare (anglisht, frëngjisht, gjermanisht).

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën 16.02.2024, ora 10:00.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **Blerje karburant gazoil deri ne 10 ppm (Naftë D1,Eurodiesel),Bashkia Puke**

Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.

Bashkëlidhur këtij procesverballi:

Dokumentat e tenderit.

**NJËSIA E PROKURIMIT**